

RAPORT MONITORIMI I POLITIKËS

Gjithëpërfshirja e
Fëmijëve me
Aftësi të
Kufizuara në
Arsimin
Para-Universitar

Komuna e Gjilanit

Autor: Ensar Shaqiri
Rishikues: KYC Kosova
Dizajni: Sh.P.K. "SUKI"
"Social Urban Innovation Kosova"

Të drejtat e autorit © 2025. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky dokument është pronë e KYC, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC ndalohet.

Gjithëpërfshirja e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara në Arsimin Para-Universitar

Rasti Shembull - Komuna e Gjilanit



Ky raport u realizua me mbështetjen financiare të Unicef Kosovo Programme, IOM Kosovo dhe Peacebuilding Fund, si produkt i iniciativës së implementuar nga KYC Kosova dhe Këshilli i Nxënësve të Gjilanit.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk shprehin medoemos qëndrimet e autorëve/rishikuesve, KYC-it apo të donatorëve.

Hyrje

E drejta për arsim është themelore për çdo fëmijë, përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Në Kosovë, kuadri ligjor dhe politik synon të sigurojë arsim gjithëpërfshirës, duke përfshirë masa të qarta për mbështetjen dhe zhvillimin e tyre akademik dhe social. Përfshirja e këtyre fëmijëve në sistemin arsimor kërkon një qasje të shumëanshme, duke marrë parasysh aspektet ligjore, institucionale dhe praktike për të garantuar një mjedis të përshtatshëm për mësim dhe zhvillim. Megjithatë, përmbushja e këtij obligimi shpeshherë rrezikohet nga faktorë të ndryshëm, si mungesa e burimeve njerëzore në institucione, mungesa e hapësirave të posaçme, mungesa e infrastrukturës dhe faktorë të tjerë.

Për të siguruar monitorimin efektiv të politikave të përfshirjes, ky dokument analizon situatën aktuale të arsimit gjithëpërfshirës në Gjilan, përfshirë legjislacionin përkatës, institucionet përgjegjëse dhe sfidat kryesore me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara. Dokumenti gjithashtu synon të propozojë strategji për përmirësimin e implementimit të politikave ekzistuese dhe të japë rekomandime për të ardhmen, duke përfshirë përmirësimet në infrastrukturë, burime njerëzore dhe mbështetjen institucionale dhe më gjerë.

Gjithëpërfshirja në arsim nuk është vetëm një detyrim ligjor, por edhe një aspekt thelbësor dhe moral për zhvillimin e barabartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Metodologjia

Monitorimi u zhvillua duke përdorur një qasje të kombinuar të hulumtimit me gjetjet në rrjete sociale dhe mediave online (portaleve komunale), intervistave me palë kyçe dhe të hulumtimit të dokumenteve. Metodatat e përdorura përfshijnë:

Hulumtimi i dokumenteve zyrtare (Desk Research): Për të kuptuar kuadrin ligjor, politik dhe strategjik mbi përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

- **Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Kosovë:** përcakton parimet e arsimit gjithëpërfshirës.
- **UA 23/2013 për Qendrat burimore;**
- **Udhëzimi administrativ nr. 02/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MASHT) nr. 16/2027:** për vlerësimin pedagogjik për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- **Plani Strategjik për Arsimin Gjithëpërfshirës (2021-2026):** Adreson masat për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- **Plani Individual i Arsimit (PIA) dhe udhëzuesi për hartimin e planit individual të Arsimit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore:** Zhvillimin dhe mbështetjen arsimore të fëmijëve.
- **Strategjia Kombëtare e Arsimit (2022-2026):** Vendosi objektiva për një arsim të qasshëm dhe cilësor.
- **Plani Zhvillimor i arsimit (2023-2026) në komunën e Gjilanit:** Vendosi qëllimet komunale duke u harmonizuar me Ministrinë e Arsimit.

Intervista me palë kyçe: U zhvilluan intervista të strukturuar mbi gjendjen reale të institucioneve dhe proceseve.

Analiza në rrjete sociale dhe media online: Hulumtim i burimeve në internet, si intervista, diskutime publike, ngjarje në rrjete sociale, podcast, konferenca për media.

Analiza Politikave Ekzistuese dhe Zbatimi në Praktikë

Institucionet shtetërore kanë të krijuar dokumentet për menaxhimin e rasteve për fëmijët me aftësi të kufizuara, por jo dhe shumë në mënyrë specifike. Ligjet dhe udhëzimet administrative shpesh bien ndesh me praktikën, sidomos në rastet kur bëhet fjalë për infrastrukturën në shkolla. Zbatimi i tyre është i kufizuar për shkak të mungesës së burimeve të nevojshme dhe mungesës së trajnimeve për palët që janë të përfshira.

Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Kosovë. Ky ligj trajton dhe rregullon edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve duke përfshi edhe personat me aftësi të kufizuara. Ky dokument trajton specifikisht që komunat sigurojnë transport falas, të sigurt dhe të përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara apo me vështirësi në mësim që ndjekin mësimet në shkollë komunale. Në praktikë ky transport nuk ekziston, duke luajtur rol në hezitimin e familjeve në dërgimin e personave me aftësi të kufizuara për shkollim të mëtutjeshëm. Krahas kësaj, ligji i lartpërmendur rregullon çështjen që Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë obligohet të ofrojë ndihmë për të siguruar përshtatshmërinë e ndërtesave shkollore dhe të pajisjeve sipas standardeve ndërkombëtare për shëndet dhe siguri, si dhe për mbrojtje të mjedisit, për të siguruar qasje të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe pajisjet ndihmëse për përkrahjen e arsimit gjithëpërfshirës. Komuna nuk kërkon sa duhet ndihmë nga Ministria për krijimin e ashensorëve dhe tualeteve për shfrytëzim nga personat me aftësi të kufizuara. Kjo pamundëson qasjen në laboratore dhe klasa të veçanta në të gjithë objektin.

Plani Zhvillimor i arsimit (2023-2026) në komunën e Gjilanit. Ky dokument rregullon planifikimet afatgjate duke u fokusuar në katër fusha kryesore me top prioritet, që në të cilën nuk gjendet fokusi në fushën e personave me aftësi të kufizuara. Sidoqoftë, ky dokument flet në mënyrë jo specifike për trajtimin e kësaj fushe. Dokumenti njofton se janë bërë përpjekje për të përmirësuar qasjen dhe mbështetjen për këta nxënës, si p.sh. punësimi i asistentëve dhe mbulimi i disa nevojave në shkolla. Megjithatë, disa sfida mbeten të pazgjidhura. Shumë mësimdhënës nuk kanë përgatitjen e duhur për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara, duke e bërë të vështirë përshtatjen e metodave të mësimdhënies. Edhe pse komuna vazhdon me ritëm të mirë të punësimit për stafin mbështetës, ky numër është ende i vogël me nevojën reale. Duke patur parasysh numrin e vogël të stafit mbështetës, zbatimi i politikave dhe udhëzimeve për përfshirjen e tyre është i ngadalshëm dhe jo shumë efektiv në praktikë.

Plani Individual i Arsimit (PIA) dhe udhëzuesi për hartimin e planit individual të Arsimit për fëmijë me aftësi të kufizuara arsimore. Plani Individual i Arsimit (PIA) është një dokument i cili fokusohet në zhvillimin dhe mbështetjen arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ky dokument siguron udhëzime për hartimin e planit të personalizuar të arsimit për këta fëmijë, duke përfshirë aspektet pedagogjike, rehabilituese dhe mbështetëse. PIA kërkon një bashkëpunim të madh mes shkollave, prindërve dhe institucioneve tjera, por në praktikë ky koordinim është i mangët. Prindërit shpesh nuk kanë mbështetje të mjaftueshme për të kontribuar në mënyrë aktive në edukimin e fëmijëve të tyre. Përveq kësaj barriere, për të qenë pjesë aktive e edukimit të fëmijëve të tyre, prindërit kanë nevojë për trajnime ose këshillime mbi mënyrën se si mund të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të fëmijës. Megjithatë, programe të tilla mungojnë plotësisht.

Monitorimi zbulon se:

- Psikologët dhe stafi mbështetës janë të mbingarkuar dhe nuk mund të ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për të gjithë nxënësit në nevojë.
- Në rastet kur në shkolla ka nxënës me aftësi të kufizuara, nxënësit e shkollës nuk njoftohen dhe nuk mbajnë ndonjë trajnim se si duhet të kenë sjelljen, për të tentuar që t'i inkuadrojnë në shoqëri apo ti ndihmojnë në detyra të përditshme.
- Pavarësisht që ligjet dhe dokumentet aktuale nuk adresojnë në mënyrë të detajuar çështje thelbësore si pjerrinat, shumica e shkollave kanë qasje për nxënësit me aftësi të kufizuara (pjerrinat). Por, kjo qasje kufizohet vetëm për klasët në katin e parë, duke u pamundësuar që të marrin pjesë në laboratore apo klasë në katet e tjera, në mungesë të ashensorit që duhet të posedojë shkolla për të plotësuar kushtet infrastrukturore për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Pothuajse në asnjë shkollë, nuk ka tualete të përshtatshme për persona me aftësi të kufizuara.
- Stafi i Shkollës nuk kujdeset specifikisht që dhomat e laboratorëve të gjenden në katet e para, për të mundësuar qasje nga të gjithë.
- Bashkëpunimi i mangët midis shkollave dhe shërbimeve shëndetësore.

Progresi, përmirësimet dhe praktikat e mira

Komuna e Gjilanit në raport me komunat e tjera qëndron mirë në ofrimin e kushteve për personat me aftësi të kufizuara. Praktika dhe iniciativa të mira janë nxjerrur nga monitorimi i politikave, që rekomandohen të vazhdojnë:

- Komuna e Gjilanit bashkëpunon me organizata të tjera për përmirësimin e kushteve dhe arritjen e objektivave. Në këtë mënyrë janë krijuar të gjitha kushtet në shkollën “Musa Zajmi” në Gjilan.
- Në shkollën e mesme Teknike, është bërë bartja e laboratorit nga kati i dytë në katin e parë në mënyrë që nxënësit pa dallim të ndjekin praktikën në laborator.
- Komuna e Gjilanit, është vlerësuar nga UNICEF-i si një model për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Komuna organizon kampanja vetëdijësuese në bashkëpunim me shkolla, organizata partnere dhe institucione.
- Komuna e Gjilanit ka punësuar në total asistentë brenda 3 viteve, ku numri ka shkuar total në 29, sa ishte 3 në fillim. Kjo përmes kapaciteteve të komunës dhe bashkëpunimeve që ka krijuar me organizata të tjera.
- Nxënësit kanë klubet e psikologjisë, ku mësohet dhe trajtohen çështje të ndryshme që direkt kanë të bëjnë me nxënësit.
- Komuna e Gjilanit ka krijuar dhe funksionalizuar 6 dhoma burimore.
- Komuna e Gjilanit e digjitalizon dhomën burimore, si model për herën e parë në Kosovë.

Rekomandime për Përmirësim

Bazuar në gjetjet kryesore të monitorimit, rekomandohen hapat e mëposhtëm për të përmirësuar zbatimin e politikave në shkolla:

Përmirësime të Politikave

- Zhvillimi i një Plani Veprimi për Gjilanin, i cili do të përcaktojë masa konkrete për përmirësimin e arsimit gjithëpërfshirës në nivel lokal.
- Forcimi i mekanizmave të monitorimit, duke përfshirë raporte të rregullta nga shkollat për përparimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Zhvillimi i udhëzimeve të detajuara për Planet Individuale Arsimore (PIA) dhe standardizimi i zbatimit të tyre në të gjitha shkollat e Gjilanit.

Rritja e Kapaciteteve




- Të vazhdohet trendi rritës i stafit mbështetës, ku brenda 3 viteve, nga 3, numri ka shkuar në 29 persona të angazhuar si asistentë për të ofruar ndihmë të drejtpërdrejtë për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Trajnime të vazhdueshme për mësuesit dhe prindërit mbi metodat e edukimit gjithëpërfshirës dhe menaxhimin e klasave me nevoja të ndryshme.
- Krijimi i një qendre të ekspertizës për arsimin gjithëpërfshirës në Gjilan, e cila do të mbështesë mësimdhënësit dhe shkollat me burime, trajnime dhe këshillime.

Përmirësimi i Infrastrukturës

- Modernizimi i shkollave në Gjilan, për të siguruar që të gjitha ambientet shkollore të jenë të qasshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Instalimi i rampave dhe ashensorëve në të gjitha shkollat që nuk kanë qasje të përshtatshme për fëmijët me vështirësi në lëvizje.
- Në rast të mungesës së fondeve për ashensorët, të vazhdohet bartja e laboratorëve në katet e para të shkollës, ku kanë të siguruar qasje për të gjithë nxënësit në të gjitha shkollat, sikur është vepruar me shkollën e mesme teknike.
- Përmirësimi i transportit shkollor të përshtatur, për të siguruar që fëmijët me aftësi të kufizuara të mund të ndjekin shkollën pa pengesa.
- Vazhdimi i trendit të sigurimit të laboratorëve, hapësirave mësimore të personalizuar dhe dhomave burimore, ku nga 0 sa ishin, tani numri ka shkuar në 6, për të ndihmuar fëmijët me nevoja të ndryshme në zhvillimin e aftësive praktike.

Angazhimi dhe bashkëpunimi i Komunitetit

- Krijimi i klubeve të psikologjisë, në të gjitha shkollat e komunës, nga nxënësit.
- Krijimi i grupeve mbështetëse për prindërit, për të ndihmuar ata/ato që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të ndajnë përvoja dhe për të marrë mbështetje profesionale.
- Bashkëpunimi i ngushtë me OJQ-të dhe institucionet shëndetësore për të ofruar shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Përfshirja e bizneseve lokale dhe sektorit privat, për të ofruar mbështetje financiare dhe teknologjike për shkollat dhe nxënësit me aftësi të kufizuara.



Prishtinë, 2025